



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

Datë 26/11/2019

Drejtuar: Operatorit ekonomik “SUPERIOR KLIMA” shpk
Adresa: Njesia Bashkiake nr.5, Rruga "Sulejman Delvina", Pallati "Melrose",
Dyqani nr.2, Kati 1, Tiranë

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

* * *

Procedura e prokurimit: “Kërkesë për propozim” - mallra

Referenca e procedurës: REF-39866-10-16-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje kondicionerë për Bashkinë e Tiranës, për vitin 2019”

Fondi limit: 2.083.333 (dy milion e tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh

Afati i dorëzimit të mallit: Nga data e nënshkrimit të kontratës operatori fitues duhet të lëvrojë mallin sipas kërkesave dhe në datat e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor. E gjithë sasia e mallit të sillet brenda 5 ditëve pune nga lidhja e kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 29/ 10/ 2019, ora 11:30

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike: Nr. 42 datë 21 Tetor 2019

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “CLIMACASA” shpk

NUIS L07805502F

Vlera e ofertës pa TVSH– 1.887.000 (një milion e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 2.264.400 (dy milion e dyqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekë.

2. Operatori ekonomik “Klima Teknika TB 2” shpk

NUIS K49322506W

Vlera e ofertës pa TVSH– 1.509.770 (një milion e pesëqind e nëntë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 1.811.724 (një milion e tetëqind e njëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e njëzetë e katër) lekë.

3. Operatori ekonomik “Superior Klima” shpk

NUIS K91712015L

Vlera e ofertës pa TVSH– 2,071,445 (dy milion e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e dyzetë e pesë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 2.485.734 (dy milion e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër) lekë.

4. Operatori ekonomik "SULOLLARI-KLIMA" shpk

NUIS K01529003M

Vlera e ofertës- 0 lekë

Janë s'kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik "CLIMACASA" shpk
2. Operatori ekonomik "Klima Teknika TB 2" shpk
3. Operatori ekonomik "SULOLLARI-KLIMA" shpk

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Operatori ekonomik "CLIMACASA" shpk është s'kualifikuar për arsyet e mëposhtme:

1. Nga verifikimi i bërë dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik „Climacasa“ shpk u konstatua se për plotësimin e kriterit pika 2.3.4, OE ka paraqitur 3 mjete perkatesisht me targa si më poshtë vijon:

1. Mjeti me targa AA ... EE me kapacitet mbajtës 775 kg ndërkohë që nga AK është kërkuar minimumi i kapacitetit total mbajtës 1.5 ton.
2. Mjeti me targa TR M me kapacitet mbajtës 749 kg ndërkohë që nga AK është kërkuar minimumi i kapacitetit total mbajtës 1.5 ton.
3. Mjeti me targa TR M me kapacitet mbajtës 749 kg ndërkohë që nga AK është kërkuar minimumi i kapacitetit total mbajtës 1.5 ton.

Një ndër dokumentacionet që duhet të shoqërojnë mjetin është edhe certifikata e transportit e lëshuar nga Bashkia Tiranë (sipas urdhërit të Bashkisë Tiranë për mjetet me kapacitet mbajtës mbi 1.5 ton), qe lejon transportin ne territorin e kesaj bashkie.

OE sa më sipër cituar nuk e ka paraqitur një dokumentacion të tillë por ka paraqitur një deklaratë ku deklarojnë se do të pajisen me këtë leje transporti vetëm nëse ata do të shpallen fitues për procedurën objekt prokurimi.

2. Në pikën 2.3.3 të kriterëve për kualifikim është kërkuar që:

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar një numër minimal prej 12 (dymbëdhjetë) punonjës për periudhën Janar-shtator 2019 ku të përfshihet edhe stafi teknik i shoqërisë. Për përmbushje e këtij kriteri Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Vërtetim nga Administrata Tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për kete periudhë
- Listë pagesat për periudhën e kërkuar sipas formatit të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

a. Operatori ekonomik për realizimin e këtij objekti duhet të vërtetojë se ka të punësuar në stafin e tij dhe të figurojnë në listë pagesa për periudhën Janar-shtator 2019, personel teknik si më poshtë:

- 1 (një) specialist saldator
- Minimumi 2 (dy) specialist elektrikiste
- **Minimumi 4 (kater) specialist kondicionimi**

Për specialistët e mësipërm duhet të paraqitet Kontratë Pune e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, si dhe certifikimet profesionale dëshmi profesionale (IQT) të tyre lëshuar nga organet certifikuese kompetente.

- 1 (një) inxhinier mekanik (drejtues teknik)
- 1 (një) inxhinier elektrik (drejtues teknik)

Për drejtuesin teknik- Inxhinier mekanik dhe inxhinier elektrik duhet të paraqitet Kontratë Pune e vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, diplomë dhe Librezë pune.

Nga verifikimet e kryera KVO konstaton se përsa i përket specialistëve të kondicionimit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik „Climacasa“ shpk në plotësim të kriterit sa më sipër cituar sikundër janë Z. B.Ç., Z. A. D., Z. D. D., Z. A. N. nuk kanë paraqitur dëshmi kualifikimi që garanton njohuritë e duhura për ushtrimin e këtij lloji profesioni por vetëm disa certifikata trajnimi të lëshuara nga organizmi ndërkombëtar AQSCERT. Referuar parashikimeve të ligjit 13/2013 „Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8734, datë 01.02.2001 „Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike, certifikimi dhe pajisja me dëshmi e punonjësve bëhet nga IQT (ISHTI-sot) ose organ i akredituar certifikues personeli në fushën përkatëse, sipas dispozitave ligjore në fuqi lidhur me garantimin e sigurisë së punës për përdorimin e pajisjeve elektrike. Certifikatat e paraqitura tregojnë trajnimin e punëmarrësve në lidhje me përfitim të njohurive dhe aftësive profesionale si specialist kondicionimi, por nuk kanë të bëjë me trajnimin dhe përgatitjen e mjaftueshme të punonjësve që punojnë në pajisjet dhe instalimet elektrike, që nuk kanë njohuritë e duhura lidhur me garantimin e sigurisë në punë gjatë ushtrimit të këtij profesioni që është edhe qëllimi i kërkesës së këtij kriteri. Gjithashtu AK mbas verifikimeve të kryera në rrugë elektronike në faqen elektronike të AQSCERT konstatoi se me të dhënat numrat përkatës të certifikimeve për secilin specialist nuk gjendet asnjë lloj informacioni që këto certifikata ekzistojnë dhe janë të vlefshme. Aksesimi në faqen elektronike të AQSCERT sipas printscreen –eve (dokumentuar në dosjen e prokurimit).

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori ekonomik “Klima Teknika TB 2” shpk është s’kualifikuar për arsyet e mëposhtme:

1. Nga verifikimi i kryer në Ekstraktin Historik të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Klima Teknika TB 2” shpk, në rubrikën “*Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit*” rezulton se aktualisht kjo shoqëri ushtron aktivitet dhe është operativ në Tiranë, Gjirokastrë, Fier.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se operatori ekonomik “Klima Teknika TB 2” shpk nuk ndodhet në kushtet e përmbushjes së kërkesës së autoritetit kontraktor për shlyerjen e detyrimeve të taksave vendore siç është parashikuar në dokumentat e tenderit, pasi dokumentacioni i paraqitur prej tij vërteton shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore vetëm për Bashkinë e Tiranës dhe Gjirokastrës ndërkohë që nuk vërteton shlyerjen e këtyre detyrimeve për Bashkinë Fier ku ai rezulton të jetë operativ.

Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”.

Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, 7 parashikohet: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*”.

Në vijim në Nenin 12 “Regjistrimi dhe Liçensimi” të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar parashikohet se: *Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me*

ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Në pikën 6 të këtij neni citohet gjithashtu se: “Kur taksapaguesi kryen një biznes në më shumë se një vendndodhje, ai pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo vendndodhje të biznesit dhe taksa llogaritet më vete për çdo vendndodhje”.

2. Inxhinieri elektrik i deklaruar dhe paraqitur në përmbushje të kriterëve të vecanta për kualifikim Znj. L. M nuk figuron në licensën e shoqërisë si drejtuese teknike .

3. Deklarata e disponimit të mjetit nuk përmban objektin e procedurës së prokurimit të Bashkisë Tiranë por të një Autoriteti tjetër kontraktor.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Operatori ekonomik “SULOLLARI-KLIMA” shpk është s’kualifikuar për arsyet e mëposhtme:

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria **Operatori ekonomik “Sulollari-Klima”** nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar tek kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik **“Sulollari-Klima” s’kualifikohet** pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “SUPERIOR KLIMA” shpk** me adresë: Njesia Bashkiake nr.5, Rruga "Sulejman Delvina", Pallati "Melrose", Dyqani nr.2, Kati 1, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **2,071,445 (dy milion e shtatëdhjetë e një mijë e katërqind e dyzetë e pesë) lekë pa TVSH dhe 2.485.734 (dy milion e katërqind e tetëdhjetë e pesë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër) lekë me TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të

veprohet sic parashikon Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 18.11.2019.

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, **nuk është paraqitur asnjë ankesë.**